

Në bazë të nenit 12 të Vendimit mbi financimin e sportit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale" numër 032/19), pas përfundimit Konkursit publik numër 04-032/20-2350 prej më 04.03.2020., e në propozim të Komisionit për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e vlerës së mjeteve organizatave sportive, Kryetari i Komunës, s j e ll ë

## V E N D I M

### Mbi bashkëfinancimin e programit të punës të klubeve sportive

#### I

Nga Buxheti i Komunës së Tuzit për vitin 2020, e në bazë të Konkursit publik të shpallur dhe të publikuar për bashkëfinancimin e programit të punës të organizatave sportive, listës së renditjes dhe në propozim të Komisionit për vlerësimin e programit për përcaktimin e vlerës së mjeteve ndaj klubeve sportive, mjetet shpërndahen si në vijim:

Nr.r	Emri i organizatës sportive	Selia e klubit sportiv	Vlera e mjeteve për bashkëfinancim
1.	Teakwondo klub „Besa”	Tuz	8.500,00
2.	Klubi i futbollit „Malesija 2010”	Tuz	5.000,00
3.	Teakwondo klub „Alba”	Tuz	2.800,00
4.	Klubi futbollistik „Tuzi”	Tuz	1.700,00
	<b>Totali</b>		<b>18.000,00</b>

#### II

Klubet sportive të përmendura në paragrafin I, të cilëve u janë ndarë mjete me këtë vendim, do të nënshkruajnë një kontratë me Komunën e Tuzit, e cila do të specifikojë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, dinamikën e pagesave dhe mënyrën e përdorimit të fondeve të ndara. Fondet e përmendura në paragrafin I, të cilat janë ndarë me këtë vendim, do të paguhen nga pozicioni i Buxhetit të Komunës së Tuzit për vitin 2020 - transferime në institucionet sportive, klasifikimi ekonomik 4313.

Klubet sportive nga paragrafi I janë të detyruara t'i shpenzojnë fondet e alokuara për qëllimin e synuar, në përputhje me programin dhe planin e fondeve të shpenzimit, krahas detyrimit të paraqitjes së një raporti me dëshmi të shpenzimeve, brenda afateve të përcaktuara me Vendimin për financimin e sportit, në mënyrën e përcaktuar sipas kontratës së nënshkruar.

### III

Vendimi mbi ndarjen e mjeteve për realizimin e programeve të klubeve sportive do të publikohet në web sajtin e Komunës së Tuzit

### IV

Ky Vendim hynë në fuqi me ditën e sjelljes.

## ARSYETIM

Në pajtim me nenin 12 të Vendimit mbi financimin e portit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale” numër 032/19) është paraparë që Vendimin mbi bashkëfinancimin e programeve të organizatave sportive e sjellë kryetari i Komunës, me propozim të Komisionit.

Në bazë të nenit 11 të Vendimit mbi financimin e sportit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, numër 032/19) është paraparë që Komisioni pas vlerësimit të programit dhe përcaktimit të vlerës së mjeteve ndaj organizatës sportive, kryetarit të Komunës i dorëzon propozimin e arsyetuar të Vendimit mbi bashkëfinancimin e programit të organizatave sportive. Me paragrafin 2 të të njëjtit nen është paraparë që Propozimi i Vendimit për bashkëfinancim duhet të përmbajë: emërtimin e organizatës sportive, selinë e organizatës sportive, vlerën e mjeteve për bashkëfinancim.

Sekretariati për vetëqeverisjen lokale i Komunës së Tuzit ka shpallur Konkursin Publik për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive për vitin 2020., numër 04-032/20-2350 prej më 04.03.2020. ku të njëjtin e ka publikuar përmes mjeteve të shkruara, në faqen e Komunës së Tuzit [www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me) në tabelën e lajmërimeve të Komunës, si dhe në median lokale „Tv Boin“.

Kryetari i Komunës së Tuzit miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për vlerësimin e programeve dhe përcaktimin e shumës së fondeve për organizatat sportive Nr. 04-032 / 20-2126 nga 27 shkurti i vitit 2020., me detyrë të vlerësojë programin e punës së klubeve sportive, si dhe pas vlerësimit, t'i paraqesë Kryetarit të Komunës së Tuzit një propozim të arsyeshëm për bashkëfinancimin e programit të punës së klubeve sportive.

Në bazë të nenit 7 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së Komisionit, Komisioni për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e shumës së fondeve për organizatat sportive ka përcaktuar Listën e Renditjes së klubeve sportive që plotësojnë kërkesat e konkursit publik për vitin 2020 numër 04-032 / 20-6306 nga 02.07.2020.

Në bazë të nenit 7, paragrafit 5 të rregullores së punës së komisionit nr. 04-032 / 20-2288, të datës 2 mars 2020, Komisioni për vlerësimin e programeve dhe përcaktimin e fondeve për organizatat sportive, i dorëzoi kryetarit propozimin e arsyeshëm për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive nr. 04-032 / 20-6307 datë 2. korrik 2020.

Komisioni për shpërndarjen e mjeteve ndaj të klubeve sportive ka shqyrtuar paraqitjet e dorëzuara sipas Konkursit që është cekur dhe sipas kritereve që janë përcaktuar me Rregullore, ka hartuar

propozimin me të cilin i ka propozuar kryetarit të Komunës që të sjellë Vendim mbi ndarjen e mjeteve ndaj klubeve sportive.

Klubet sportive janë të detyruara që mjetet që u janë paguar nga Buxheti i Komunës t'i shpenzojnë për qëllimet për të cilat edhe janë miratuar. Klubi sportiv i cili mjetet për bashkëfinancim të programit të punës i shpenzon për qëllime të tjera, është i detyruar që me kërkesë të Komunës së Tuzit, t'i kthejë ato përsëri, në shumë që i janë paguar. Kontrolli i realizimit të programit bëhet në bazë të raportit vjetor mbi shpenzimin e mjeteve të shpërndara.

Me secilin klub sportiv, Komuna do të nënshkruaj kontratë me të cilën do të precizohen të drejtat dhe detyrimet e palëve të marrëveshjes, në pajtim me Ligjin mbi Sportin dhe Vendimit mbi financimin e sportit.

Vendimi do të publikohet në Web sajtin e Komunës së Tuzit.

Vendimi hynë në fuqi me ditën e sjelljes.

Në bazë të asaj që është thënë, është vendosur si në dispozitiv.

#### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij Vendimi mund të ngritët kontesti administrativ në afat prej 20 ditësh nga dita e dorëzimit të Vendimit.

#### **Dorëzuar:**

- Klubeve sportive;
- Sekretariatit për financa dhe zhvillim ekonomik;
- Sekretariatit për vetëqeverisjen lokale;
- a/a.

**KRYETARI,**  
M. A. Nik Gjelošhaj  
*Jran* *Jranaj*

